



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1469/4 Prot.

Tiranë, më 20.12.2022

V E N D I M

Nr. 223, datë 20.12.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 172, datë 10.11.2022, e bërë nga I.Xh kundër Komisionit të Posaçëm të Pensioneve të Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës¹” dhe “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Nga data 17.04.1975 deri në datë 31.01.2000, bazuar në librezën e punës kam punuar në Ndërmarrjen Shtetërore Gjeologjike Bulqizë. Në vitin 1980 kam kryer një kurs 9-muaj për specializim në Teknologjinë e Shpimit të Puseve të Mineraleve të Kromit dhe si xhenerik mekanik për makineritë që dispononte ndërmarrja. Puna e gjithë këtyre viteve me përkushtim në Ndërmarrjen Gjeologjike Bulqizë u shpërblye kur me datë 21.10.1986, në bazë të dekretit nr. 7074, nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Socialiste të Shqipërisë më është dhënë medalje për punë të shquar në Miniera Gjeologji, në kërkim zbulimin e vendburimeve të reja të kromit. Meqënëse dokumentacioni është dorëzuar në rregull, sipas ligjit i jam drejtuar Këshillit të Qarkut Tiranë për përfitimin e pensionit të posaçëm. Me shkresën nr. 1714, datë 29.03.2019 mora përgjigje nga Këshilli i Qarkut ku më sugjeronte ti drejtohesha Ministrisë së

¹ Referuar librezës nr. 254106 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ankuesi nga data 12.06.2017 përfiton pension pleqërie.

² Nënveftësim për miratim të pensionit të posaçëm sipas ligjit.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kompetent. Bëra aplikimin tek ministria, ku me shkresën nr. 1137/1, datë 03.06.2019 mora përgjigje, e cila propozonte dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), neni 5/b, si dhe me VKM nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, të ndryshuar. Sipas ligjit aplikova te Komisioni i Posaçëm i Këshillit të Ministrave, për pension të posaçëm, dhe me datë 27.08.2020 kam marrë përgjigje nga bashkëqeverisja, ku thuhej se je i ligjshëm, por nuk kemi buxhet. Aplikova dhe në vitin 2021 dhe mora përgjigje të njëjtë nga bashkëqeverisja. Aplikova dhe për vitin 2022 dhe mora të njëjtën përgjigje, se nuk kemi buxhet”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1469/1, datë 23.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Këshilli i Ministrave me shkresën nr. 6533/1, datë 05.12.2022, sqaroi ndër të tjera procedurën e ndjekur lidhur me procesin e shqyrtimit të propozimit për dhënien e pensionit të posaçëm nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës për I.Xh, si dhe vlerësoi se Komisioni i Posaçëm dhe institucioni iniciues (KM) nuk janë shtyrë nga motive diskriminuese, për shkak të moshës, gjatë shqyrtimit të propozimit për I.Xh.

Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i përcolli subjektit ankues informacionin e vënë në dispozicion nga ana e Këshillit të Ministrave.

Në vijim, ankuesi me shkresën datë 15.12.2022, iu drejtua institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke kërkuar të tërhiqet nga ankesa nr. 172, datë 10.11.2022.

Në nenin 90/3 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga I.Xh, i cili me anë të kërkesës së paraqitur me shkresën, datë 15.12.2022 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës

duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa⁵.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 172, datë 10.11.2022, paraqitur nga I.Xh, kundër Komisionit të Posaçëm të Pensioneve të Këshillit të Ministrave, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Për analogji referojmë Vendimet nr. 121, datë 16.06.2022 dhe nr. 194, datë 17.10.2022 të Komisionerit.